

UDHËZIM
Nr. 8, datë 3.3.2026

**PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 16, DATË 3.4.2020, “PËR FATURËN
DHE SISTEMIN E MONITORIMIT TË QARKULLIMIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 47, të ligjit nr. 87, datë 18.12.2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin e ministrit të Financave, nr. 16, datë 3.4.2020, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në shkronjën “b”, të pikës 3, të nenit 9, bëhet ndryshimi si vijon:

“Në rastet e eksportimit të mallrave jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, kur blerësi është individ i paregjistruar, si subjekt për ushtrimin e aktivitetit tregtar, në faturë shënohet emri i tij i plotë, numri personal i identifikimit ID dhe adresa e saktë e destinacionit ku do të dërgohen mallrat”.

2. Në pikën 13, të nenit 20, togfjalëshi “ditën e dhjetë” zëvendësohet me togfjalëshin “ditën e njëmbëdhjetë”.

3. Në pikën 4, të nenit 25, togfjalëshi “3 ditë” zëvendësohet me togfjalëshin “shtatë ditë”.

4. Kudo në përmbajtjen e udhëzimit togfjalëshi “tatimit mbi fitimin” zëvendësohet me togfjalëshin “tatimit mbi të ardhurat e korporatës” dhe togfjalëshi “tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël” zëvendësohet me togfjalëshin “tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi”.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj